



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

Durrës më 27.10.2021

Lënda : Njoftim për konsultim publik të projekt-vendimit

Në mbështetje të nenit 18, të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak Durrës përpara shqyrtimit dhe miratimit të disa akteve zhvillon konsultime.

Me dorëzimin pranë Sekretares së Këshillit Bashkiak të Projekt-Vendimit dhe Relacionit “**PËR MIRATIMIN E NGRITJES, PËRBËRJES DHE FUNKSIONIMIN TË KËSHILLIT TEKNIK KONSULTATIV PRANË BASHKISË Durrës**”, të propozuar nga Zëvendëskryetarja e Bashkisë Durrës, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak ka nisur procesin e Konsultimit Publik.

Në kuadër të këtij procesi, Këshilli Bashkiak publikon këtë projekt-vendim, në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al), sipas parashikimeve të ligjit Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Për këtë qëllim, mirëpresim çdo koment dhe sugjerim Tuajin, mbi këtë projekt-vendim, të cilat duhet të dërgohen në adresën e e-mail : keshillidurres@gmail.com, brenda 20 ditëve nga publikimi në faqe.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARE KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Dorina Milja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

PROJEKTVENDIM

Nr. ____ DATË ____/____/2021

PËR MIRATIMIN E NGRITJES, PËRBËRJES DHE FUNKSIONIMIN TË KËSHILLIT TEKNIK KONSULTATIV PRANË BASHKISË DURRËS

Në zbatim të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar; ligjit nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar; ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, VKM-së nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar; VKM-së nr.319, datë 12.4.2017 “Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave”, VKM-së nr.159, datë 1.3.2017 “Për miratimin e standardeve të projektimit të kopshteve”, VKM-së nr.530, datë 20.7.2016 “Për miratimin e standardeve të projektimit të çerdheve”, VKM-së nr.628, datë 15.7.2015 “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve” i ndryshuar, si dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor në fushën e projektimit dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit, VKM-së nr.459, datë 16.06.2010 për “Miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”, VKM-së nr.460, datë 16.06.2010 për “Organizimin dhe funksionimin e regjistrit të planifikimit të territorit”, dhe sipas relacionit hartuar nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e ngritjes, përbërjes dhe funksionimin të Këshillit Teknik Konsultativ pranë Bashkisë Durrës sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Ndërmarrja Rruga.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtor

Arben Isaku

PËR DPKZHT

**SEKT. I PLAN. DHE KONTROLLIT
TË ZBATIMIT TË LEJEVE**

Përgjegjës sektori

Ermal Lama

**DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE
INFR.PUBLIKE**

Drejtor

Adnand Toçila

KRYETAR

Emiriana Sako

Koncept:*D.Murataj*

Pranoi:*V.Manushi*

Miratoi:*A.Isaku*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

**RELACION
PËR MIRATIMIN E KRIJIMIT, PËRBËRJES DHE MANUALIN E KËSHILLIT TEKNIK
KONSULTATIV**

Të nderuar këshilltarë,

Bazuar në ligjin nr.8485, datë 12.5.1999 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar; ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar; ligjit nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar; ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, VKM-së nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar; VKM-së nr.319, datë 12.4.2017 “Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave”, VKM-së nr.159, datë 1.3.2017 “Për miratimin e standardeve të projektimit të kopshteve”, VKM-së nr.530, datë 20.7.2016 “Për miratimin e standardeve të projektimit të çerdheve”, VKM-së nr.628, datë 15.7.2015 “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve” i ndryshuar, si dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor në fushën e projektimit dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit, VKM-së nr.459, datë 16.06.2010 për “Miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”, VKM-së nr.460, datë 16.06.2010 për “Organizimin dhe funksionimin e regjistrit të planifikimit të territorit”, më poshtë Ju paraqesim relacionin si më poshtë ;

Bashkia Durrës në zbatim të akteve ligjore në fuqi për përmbushjen e funksioneve të saj si dhe në zbatim të buxhetit të miratuar harton projekt/preventiva në varësi të llojit të objektit, si rrugë, shkolla, çerdhe, kopshte etj.

Në hartimin e projekteve nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Bashkia Durrës vlerëson nevojën për vlerësimin e tyre më profesional nga një këshill teknik konsultativ të përbërë nga specialistë të fushës me një eksperiencë dhe më të gjerë në këtë drejtim.

Kjo do të shërbejë si një vlerësim këshillues dhe teknik për këto projekte, në mënyrë që këto projekte të jenë në përputhje me kërkesat teknike, arkitektonike dhe urbanistike.

Propozojmë që Këshilli Teknik Konsultativ të jetë me përbërjen si më poshtë:

1. Drejtori i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Bashkia Durrës.
2. Përgjegjës Sektori i Projekteve Publike, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Bashkia Durrës.

3. Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.
4. Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Durrës.
5. Përfaqësues nga Ndërmarrja Rruga.
6. Përfaqësues nga Dega Teknike e Ujësjetës Kanalizimeve Durrës.
7. Përfaqësues nga OSHEE-së, Dega Durrës.
8. Përfaqësues të Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës.
9. Përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave Shqiptare, Durrës.

Gjithashtu propozojmë që sekretar i Këshillit Teknik Konsultativ të caktohet specialist/jurist pranë Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Bashkia Durrës.

Për sa më lart, kërkojmë mirëkuptimin tuaj për miratimin e këtij materiali.

Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike
Drejtor
Adnand Toçila

Për Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit
Përgjegjës i Sektorit të planifikimit dhe kontrollit të zbatimit të lejeve
Ermal Lama

MANUALI I PROCEDURAVE TË ORGANIZIMIT

KËSHILLI KONSULTATIV TEKNIK

Neni 1

Baza ligjore

Ky Manual mbështetet në ligjin nr.8485, datë 12.5.1999 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar; ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar; ligjit nr.107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar; ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, VKM-së nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar; VKM-së nr.319, datë 12.4.2017 “Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave”, VKM-së nr.159, datë 1.3.2017 “Për miratimin e standardeve të projektimit të kopshteve”, VKM-së nr.530, datë 20.7.2016 “Për miratimin e standardeve të projektimit të çerdheve”, VKM-së nr.628, datë 15.7.2015 “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve” i ndryshuar, si dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor në fushën e projektimit dhe zbatimit të punimeve të ndërtimit, VKM-së nr.459, datë 16.06.2010 për “Miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe GIS”, VKM-së nr.460, datë 16.06.2010 për “Organizimin dhe funksionimin e regjistrimit të planifikimit të territorit”,

Neni 2

Këshilli Konsultativ Teknik

1. Këshilli konsultativ teknik i Bashkisë Durrës (KKT), është organ që ushtron kompetencat sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore të sipërcituara.
2. Këshilli konsultativ teknik në mbledhjen e tij të parë në prezencë të të gjithë anëtarëve, zgjedh Kryetarin e tij.
3. Kryetari drejton mbledhjen dhe diskutimet si dhe siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta.

Neni 3

Detyrat e Këshillit Konsultativ Teknik

1. Çdo përfaqësues i institucioneve si OSHEE, UKD etj., në cilësinë e anëtarit në këtë këshill të furnizojë me të dhëna sa herë që kërkohet lidhur me mbarëvajtjen e realizimit të investimeve në infrastrukturën publike,
2. Miratimi i detyrave të projektimit të hartuara nga Bashkia Durrës.
3. Miratimi i projekteve të hartuara nga Bashkia Durrës dhe/ose nga studio private të licensuara në fushën e projektimit.

Neni 4

Mbledhja e KTK

1. Kryetari i Bashkisë Durrës në varësi të prioriteteve në fushën e infrastrukturës publike njofton kryetarin e KTK-së për datën e propozuar për mbledhjen e radhës.
2. Kryetari njofton sekretarin mbi datën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes së radhës.
3. Sekretari elektronikisht njofton të gjithë anëtarët e tjerë mbi datën, kohën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës shoqëruar me materialin përkatës. Ky njoftim dërgohet 5 ditë kalendarike para datës së caktuar për mbledhje.
4. KTK kryesohet nga Kryetari dhe në mungesë e me porosi të tij, nga anëtarë të tjerë.

Neni 5

Shqyrtimi i materialeve

1. KTK shqyrton materialet e dërguara elektronikisht nga sekretari i KTK, sipas datës së njoftuar.
2. KTK vendos në zbatim të legjislacionit në fuqi për materialin që do të shqyrtojë, si dhe propozon përmirësimin e projekteve/detyrave të projektimit/ materialeve të paraqitura për miratim sa i përket aspektit urbanistik, arkitektonik dhe konstruktiv.
3. Në përfundim të çdo tematike KTK vendos për:
 - a) miratimin e materialit;
 - b) mosmiratim.
4. Këshilli konsultativ teknik referuar dhe përbërjes së tij jep mendime dhe miraton mbi projektet e hartuara nga strukturat përkatëse të Bashkisë Durrës, duke vlerësuar gjithashtu edhe investimet e planifikuara nga institucionet e tjera si OSHEE, UKD, etj.
5. Këshilli Teknik Konsultativ sa herë e vlerëson të nevojshme në ndihmë të vendimarrjes së tij, kërkon mendim nga specialistë të fushës përkatëse, nëpunës të bashkisë Durrës.
4. KTK miraton projekt/preventivat e dërguara nga studio private të licensuara në fushën e projektimit, të dorëzuara zyrtarisht pranë Bashkisë Durrës sipas nevojave/kërkesave të institucionit.
6. KTK miraton ndryshimet në projekt-preventivat që kanë të bëjnë me problematikat, dhe kompetencat në fushën e veprimtarisë të institucioneve, pjesë të këtij këshilli. Materiali mbi këto ndryshime hartohet nga personi i autorizuar nga titullari i institucionit, përgjegjës për zbatimin e punimeve të investimit publik.

Neni 6

Sekretari i KTK

1. Sekretari i KTK është përgjegjës për mirëadministrimin e organizimit të mbledhjeve.

2. Njofton anëtarët e KTK për ditën, vendin, orën e mbledhjes si dhe ju vë në dispozicion materialet që do të shqyrtohen.
3. Siguron dokumentimin e mbledhjes së Këshillit Teknik Konsultativ, listë-prezencën e pjesëmarrësve, proces-verbalin e mbledhjes
4. Me marrjen e vendimeve nga ana e KTK, kryen inventarizimin e dosjes dhe dërgimin e tyre për njohje titullarit të institucionit të bashkisë Durrës.